



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:214676  
Datë: 03.03.2025  
Numri i dokumentit: 07011902

**P.nr. 365/23**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal,** gjyqtarja e vetme gjykuese Ilda Cucović Sahatçiu, me pjesëmarrjen e praktikantit gjyqësor Dardan Tolaj, në çështjen penale kundër të pandehurit Rifat Nitaj nga fsh.V., Komuna ..... për shkak të kryerjes së veprës penale “*Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve*” nga neni 366 par. 1 të KPPK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Krimeve të Rënda, nën shenjen PP/I Nr. 173/2021 dt. 26.10.2021, pas mbajtjes së seancës dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, me datë 06.02.2025, në prezencën e Prokurorit të shtetit Ermal Demhasaj, të pandehurit Rifat Nitaj dhe mbrojtësit të tij av. Adem Nikqi, sipas autorizimit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 03.03.2025 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

***I pandehuri***

**RIFAT NITAJ** me nr. personal ....., i lindur më ....., në D., me vendbanim ne fsh. V., komuna D., nga i ati Q. dhe e ëma S. e vajzërisë Sh., ka të kryer shkollën e mesme, me profesion shofer, i martuar, i gjendjes së mire ekonomike, nr.tel. ...., i pa dënuar më parë nga gjykata, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak se:**

Më parë e gjerë më dt. 23.08.2021 rreth orës 09:00 min, në Fshatin V., K D., në kundërshtim me nenin 5 par.1 të Ligjit Për Armë Nr.05/L-022, ka mbajtur në pronësi armë e municion dhe atë: një pistoletë Glock 9x19, me nr serik ....., një karikator të të njëjtës armë 13 fishek me së

bashku me një kallëf të armës, si dhe një kuti me 7 fishek me mbishkrimin e stampuar XF SP 20, në atë mënyrë që gjatë Kontrollit e Sekuestrimit të Përkohshëm nga Njësiti i DRP –ës në Pejë, në shtëpinë e të pandehurit janë gjetur dhe sekuestruar armë e municioni në fjalë, për të cilën është konstatuar se nuk posedon leje nga organet kompetente.

- me çka ka kryer vepër penale „Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar i të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Andaj në aplikim të nenit 7, 8 par. 1, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 366 të KPRK-së, si dhe nenit 364, 449 par. 1 dhe par. 2 pika 2.6, si dhe nenit 230 të KPPRK-së, në bazë të marrëveshjes për pranimin e fajësisë nën shenjen PP/I Nr. 173/2021 të dt. 26.10.2021 të pandehurit i shqipton:

### **DËNIM ME GJOBË**

- I. **-shumen në lartësi prej pesëqind (500) euro**, e të cilin dënim i njëjti obligohet të paguaje në afat prej **pesëmbëdhjete (15) ditësh**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Nëse i pandehuri refuzon, dështon apo nuk paguan dënimin e shqiptuar me gjobë si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi në afatin e caktuar, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi duke i llogaritur shumen prej njëzetë (20) euro për një ditë burgimi. Nëse i njëjti nuk dëshiron ose nuk mund të paguaje gjobën në tërësi, gjykata do ta zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me burgim. Nëse i njëjti e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit me burgim ndërpritet.
- III. I pandehuri obligohet që gjykatës ti paguan shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumë prej tridhjetë (30) euro, dhe shumën prej njëzetë (20) euro në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit.
- IV. Konform nenit 366 par. 3 të KPRK-së e lidhur me nenin 276 par. 1 dhe 2 nën par. 2.1 të KPPRK-së, **KONFISKOHET** një armë - pistoletë Glock 9x19, me numër serik ....., një (1) karikator, trembëdhjetë (13) fishek, një (1) kallëf të armës dhe një (1) kuti me shtatë (7) fishek me mbishkrimin e stampuar XF SP 20.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Krimëve të Rënda, me datën 18.05.2021 ka ngritur aktakuzën nën shenjen PP/I Nr. 173/2021 kundër të pandehurit Rifat Nitaj nga fsh.V.

Komuna D., për shkak të kryerjes së veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 të KPPK-së.

Bashkë me aktakuzën prokuroria ka dërguar edhe njoftimin për marrëveshjen e lidhur për pranimin e fajësisë mes Prokurorisë dhe të pandehurit Rifat Nitaj se bashku me mbrojtësin të tij av. Adem Nikqi nga Peja, sipas autorizimit.

Në kuptim të nenit 230 par.18 të KPPRK-së, Gjyqtarja e vetme gjykuese ka dëgjuar pikëpamjet të Prokurorit të Shtetit, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij.

Prokurori i Shtetit në lidhje me marrëveshjen për pranimin e fajësisë deklaroi se qëndron pranë marrëveshjes së arritur në prokurori, kjo marrëveshje është bërë pasi që i pandehuri i ka kuptuar pasojat dhe natyrën e kësaj vepre penale mbi të gjitha pikat e aktakuzës të cilat i vihen në barrë.

Po ashtu, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij kanë deklaruar se mbeten në tërësi pranë marrëveshjes së arritur për pranimin e fajësisë me Prokurorin e Shtetit.

Në kuptim të nenit 230 par. 17, të KPPRK-së, gjyqtarja e vetme gjykuese e ka dëgjuar të pandehurin dhe ka vërtetuar se i pandehuri i ka kuptuar natyrën e veprës penale e cila i është vënë në barrë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, se nuk ka qenë i detyruar apo shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë ka mbështetje në fakte dhe prova materiale të paraqitura në aktakuzë dhe se nuk ekziston asnjë rrethanë për hedhje të akuzës që parashihet me nenin 248 par.1 të KPPRK-së.

Gjykata është bindur se janë plotësuar kushtet nga neni 230 par. 17, i KPP-së, respektivisht se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, çka e pohoi edhe vet i pandehuri dhe mbrojtësi i tij gjatë seancës, së pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, dhe se nuk ka qenë i shtrënguar apo i detyruar në asnjë mënyrë që ta pranojë fajësinë, gjë që po ashtu është pohuar nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, tutje gjykata gjeti së ky pranim i fajësisë ka mbështetje edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, siç janë: Raporti i policit hetues E. B. i dt. 18.08.2021, Raporti i policit hetues E.B. i dt. 23.08.2021, Raporti i hetuesit V. K. i dt. 23.08.2021, Raport i shpejtë më nr. të rastit ..... i dt. 23.08.2021, Raporti Informues nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë më nr. të rastit DDH-....., Raporti Informues nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë më nr. të rastit ....., Deklarata e të pandehurit Rifat Nitaj e dhënë në polici më dt. 23.08.2021 si dhe ajo e dhënë pranë kësaj prokurorie më dt. 15.10.2021, Deklarata e të dyshuarit S. M. e dhënë në polici më dt. 23.08.2021, Raporti i Ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë më nr. AKF/2021-..... i dt. 29.09.2021, Dy Vërtetime mbi sekuestrimin e përkohëshëm të sendeve për të pandehurin Rifat Nitaj dhe Sahit Mataj, Procesverbali për Kontroll dhe sekuestrim të përkohëshëm më nr. të rastit 2021-DI-38 i dt. 23.08.2021, Lista e dëshmimeve më nr. .... e dt.

23.08.2021, Foto-albumi i vendit të ngjarjes më nr. të dosjes ..... i dt. 23.08.2021, dhe se nuk ekziston asnjë rrethane tjetër e paraparë me nenin 248 par. 1, të KPPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 230 par. 20 të KPPRK-së ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe në pajtim me marrëveshjen, dhe ka urdhëruar që kjo marrëveshje të vendoset në shkresat e lëndës në gjykatë.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit gjykata për të pandehurin, mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, ku si rrethana lehtësuese mori sjelljen e tij korrekte në gjykatë gjatë shqyrtimit, i njëjti ka pohuar se ndjen keqardhje, faktin se është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, si dhe pranimin e fajësisë sipas marrëveshjes, si dhe faktin se i pandehuri është dhe invalid i luftës, mosha e tij të re dhe faktin se i njëjti me parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale, ndërsa si rrethana rënduese gjykata në rastin konkret për të pandehurin nuk gjeti asgjë.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë, gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikojë edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë, që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPPRK-së.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata në kuptim të nenit 366 par. 1 e lidhur me nenin 43 të KPRK-së dhe nenit 230 par.12 të KPPRK-së të pandehurit i shqiptoi dënimin me gjobë si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi për zëvendësimin eventual e dënimit të shqiptuar me gjobe me dënim burgimi në rast se i pandehuri dështon apo refuzon ta paguan dënimin me gjobë u morr konform nenit 43 par. 3 dhe 4 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u morr në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2, nën par. 2.1 dhe nën par. 2.6, të KPPRK-së, ndërsa konform nenit 36 par.1, 2, 3, nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimin, gjykata të pandehurin e obligoi në pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimin, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi konfiskimin e armës e cila konsiderohet pasuria qenësisht e rrezikshme dhe si objekt i kësaj veprë penale, është marrë konform nenit 366 par. 3 të KPRK-së, e lidhur me nenin 276 par. 1 dhe 2 nën par. 2.1 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në kuptim të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM  
Divizioni Penal  
P.nr.365/23, me datë 03.03.2025**

**Praktikanti Gjyqësor,**

---

**Dardan Tolaj**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese,**

---

**Ilda Cucović Sahatçiu**

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.